

RAPORT TRAJNIMI

Titulli: Menaxhimi i detyrave të shtëpisë në arsimin fillor

Data: 16 dhjetor 2023

Vendi: Qendra Mediale, Prishtinë

Trajnere: Lirika Berdynaj

Pjesëmarrës: Mësimdhënës të British School of Kosovo

Struktura: Trajnimi u zhvillua gjatë tërë ditës për të mundësuar interaktivitet më të madh dhe diskutime të fokusuara.

Qëllimi i trajnimit:

Qëllimi i trajnimit ishte të ofrojë qasje të reja dhe praktika efektive për menaxhimin e detyrave të shtëpisë në arsimin fillor, duke u bazuar në zhvillimin e aftësive të nxënësve, motivimin, diferencimin dhe bashkëpunimin me familjen.

Përmbajtja e Trajnimit:

Gjatë trajnimit, u trajtuan këto çështje kryesore:

- **Qëllimi dhe funksioni i detyrave të shtëpisë në arsimin fillor:**
U diskutua rëndësia që detyrat të jenë të kuptimshme, të arritshme dhe të lidhura me objektivat mësimore.
- **Llojet e detyrave të shtëpisë:**
Trajnerja prezantoi mënyra të ndryshme të detyrave – nga ushtrimet për përforsim të njohurive, tek ato eksploruese dhe krijuese.
- **Diferencimi dhe përshtatja sipas nevojave të nxënësve:**
U theksua rëndësia e përshtatjes së detyrave sipas niveleve të zhvillimit dhe stilit të të nxënësve.
- **Koordinimi ndërmjet mësimdhënësve për ngarkesën me detyra:**
Diskutim mbi ndarjen e përgjegjësisë, bashkëpunimin ndërkurrikular dhe shmangien e mbingarkesës.

- **Përfshirja e prindërve dhe komunikimi me familjen:**
U prezantuan mënyra efektive për të përfshirë prindërit në procesin e ndihmës pa e bërë detyrën në vend të fëmijës.
- **Vlerësimi dhe ndjekja e përparimit përmes detyrave të shtëpisë:**
Si të përdoren detyrat për të monitoruar përparimin dhe për të identifikuar nevojat individuale të nxënësve.

Metodologjia e përdorur:

Trajnimi u zhvillua përmes:

- Punës në grupe
- Diskutimeve të hapura dhe analizës së situatave konkrete
- Prezantimeve interaktive dhe ushtrimeve reflektuese
- Shkëmbimit të praktikave të suksesshme nga përvoja e pjesëmarrësve

Rezultatet e trajnimit:

- Pjesëmarrësit fituan njohuri dhe ide të reja për të organizuar dhe vlerësuar më mirë detyrat e shtëpisë.
- U inkurajua bashkëpunimi ndërmjet mësimeve për planifikimin më të koordinuar të detyrave.
- U rrit ndërgjegjësimi për rolin e familjes dhe komunikimin e strukturuar me prindërit.
- U identifikuan sfidat ekzistuese dhe u ndanë zgjidhje praktike për to.

Trajnimi u vlerësua pozitivisht nga të dy grupet pjesëmarrëse dhe u kërkua që tema të thellohet edhe më tej në trajnimet e ardhshme.